



## VENDIM

Nr. 342, datë 19.4.2017

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR  
LIDHJEN E KONTRATËS NDRYSHUESE  
TË QIRASË, ME TARIFËN 1  
EURO/KONTRATA, NDËRMJET  
MINISTRISË SË ZHVILLIMIT  
EKONOMIK, TURIZMIT TREGTISË DHE  
SIPËRMARRJES, SI QIRADHËNËS, DHE  
SHOQËRISË “LIBEREST”, SH.P.K., PËR  
PASURINË “AGJENCIA E REZERVAVE  
TË SHTETIT DORËZ, KOMUNA  
QENDËR, LIBRAZHD”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të vendimit nr.54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ZYRA E NOTERISE TIRANE**

Nr. \_\_\_\_\_ Rep.

Nr. \_\_\_\_\_ Kol.

## VENDOSI:

1. Dhënie e miratimit për lidhjen e kontratës ndryshuese të qirasë, me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënës, dhe shoqërisë “Liberest”, sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “Agjencia e Rezervave të Shtetit Dorëz, komuna Qendër, Librazhd”, të miratuar me vendimin nr.637, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
**Niko Peleshi**

**KONTRATE NDRYSHUESE QIRAJE  
Me tarifë simbolike 1 euro kontrata**

Në Tiranë, sot me datë \_\_\_\_ të muajit \_\_\_\_\_ të vitit 2017 (dymijë e shtatëmbëdhjetë), u paraqiten para meje noterit \_\_\_\_\_, palët kontraktuese si më poshtë vijon:

**Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes,** përfaqësuar nga Z. \_\_\_\_\_, i pajisur me letërnjoftimin nr....., me detyrë \_\_\_\_\_ në këtë Ministri, në bazë të autorizimit të Ministrit, Nr....., datë ....., që më poshtë do të quhet **“QIRADHËNËSI”**,  
Dhe



**Shoqëria “LIBEREST” sh.p.k.**, me seli në ish Magazinat e Rezervave të Shtetit, Togës, Librazhd, e regjistruar si person juridik dhe pajisur nga Q.K.B. me numër identifikimi L47606601G, përfaqësuar nga administratori i shoqërisë Z. Ismail Kadiu, i pajisur me letërnjoftimin nr. ...., madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, që më poshtë do të quhet **“QIRAMARRËSI”**.

Të cilët deklaruan se, mbështetur në pikën 3 të kreut IV “Nxitja e Biznesit” të Vendimit nr.54, datë 05.02.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, në vijim të Vendimit nr.637, datë 01.10.2014, të Këshillit të Ministrave “Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën simbolike 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënës, dhe shoqërisë “Liberest” SHPK, si qiramarrës, për pasurinë “Agjencia e Rezervave të Shtetit Dorëz, komuna Qendër, Librazhd”, si dhe në nenet 801-825 të Kodit Civil, Ministria e Zhvillimit të Ekonomisë, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, me cilësinë e “Qiradhënësit”, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë qiramarrëse “LIBEREST” sh.p.k. për një ndryshim në treguesin e punësimit të planit të biznesit nisur dhe aktorë dhe faktorë të zonës, palët bien dakord që në kontratën e qirasë, nr.540 Rep. dhe nr.114 Kol., datë 05.11.2014, të lidhur për pasurinë “Agjencia e Rezervave të Shtetit Dorëz, Komuna Qendër, Librazhd”, njësi në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, të bëhen ndryshimet si vijon:

1. Plan biznesi që i bashkëlidhet kontratës dhe që përmendet në pikat 5.4, 5.5 dhe 10.2 të kontratës së qirasë, zëvendësohet me planbiznesin që i bashkëlidhet kësaj kontrate ndryshuese qiraje.
2. Neni 5.6 i kontratës së qirasë riformulohet si më poshtë:

“5.6 Qiramarrësi” sipas parashikimit për punësimin të shprehur në plan-biznesin, bashkëngjitur kësaj kontrate, detyrohet që në objektin e marrë me qira, të realizojë punësimin e jo më pak se 55 personave. Të punësuarit e realizuar nga nënqiramarrësit në këto ambiente, të njihen si vende pune të hapura sipas nenit 5.6 të kësaj kontrate.”



Kjo kontratë ndryshuese, është pjesë përbërëse e kontratës së qirasë nr.540 Rep. dhe nr.114 Kol., datë 05.11.2014 të lidhur për pasurinë “Agjencia e Rezervave të Shtetit Dorëz, Komuna Qendër, Librazhd”, njësi në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Kontrata ndryshuese e qirasë është formuluar në gjashtë kopje origjinale dhe pasi ju lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe pranuan, e nënshkruan atë para meje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë dhe unë noter \_\_\_\_\_, në bazë të nenit 801 e vijim të Kodit Civil, e vërtetoj atë rregullisht.